



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr.1, datë 22.2.2017

PËR

MIRATIMIN E AUTORIZIMIT “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,
PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE, ME OBJEKT
“NDËRTIMI I SEKSIONIT TOKËSOR TË PROJEKTIT
TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (TAP), SEKTORËT
5B DHE 5C”

Në mbështetje të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 8, të nenit 4, dhe të nenit 84, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit “Për përdorim burimi ujqor”, për veprimtari ndërtimore në brigje, subjektit “*Trans Adriatic Pipeline AG*”, me objekt “Ndërtimi i seksionit tokësor të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), sektorët 5B dhe 5C”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
E D I R A M A

Në mungesë
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
NIKO PELESHI

